




<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

DREJTORIA E BUJQËSISË DHE PYLLTARISË
UPRAVA ZA POLJOPRIVREDU
DEPARTMENT OF AGRICULTURE

Tel/Fax: 0290 322 922
Adresa: Dëshmorët e Kombit p.n.

DATA/DATUM/DATE	22.02.2021
11 NR/BR.	11/28
PËR/ZA/TO	Tabelën e shpalljeve
NGA/OD/FROM	z. Burim Bajrami Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Thirrje për aplikim



Thirrje për aplikim për fidane të perimeve

Drejtorja e Bujqësisë dhe Pylltarisë e komunës së Ferizajt njofton fermerët kultivues të perimeve në serra se në bazë të vendimit nr.11/27 të datës 18.02.2021 në përkrahje të zhvillimit të bujqësisë për vitin 2021 do të bëjë: Subvencionimin e fermerëve kultivues të perimeve në serra me fidane të perimeve.

Vendimi është marrë me qëllim të përkrahjes së fermerëve që janë kultivues të perimeve në serra meqë është prodhimtari intensive dhe profitabile.

Me këtë projekt përfshihet subvencionimi i fermerëve me 60000 fidane të perimeve për sipërfaqen prej 15000m² serrë. Numri i fermerëve përfitues nuk është i caktuar ngase varet nga sipërfaqja për të cilën aplikojnë fermerët.

Fermerët përfitues furnizimin me fidane do ta bëjnë vetë nga ndonjë prodhues i fidaneve. Fermerët prodhuesin e fidaneve për furnizim do ta zgjedhin sipas dëshirës, ndërsa kompenzimin e pagesës e bënë Drejtorja e Bujqësisë dhe Pylltarisë bazuar në dëshminë e pagesës (faturën dhe kuponin fiskal) që duhet të sjellë fermeri përfitues.

Përfitues mund të jenë edhe fermerët që i kultivojnë fidanet e perimeve në serrat e tyre, edhe këtyre do t'iu bëhet kompenzimi për të gjitha shpenzimet e bëra për kultivimin e fidaneve të perimeve që duhet ta dëshmojnë me fatura dhe kupona fiskal. Përfituesve do t'u pranohen nga 4fidane/m² me çmim maksimumi 0.25€/1fidan.

Sipërfaqja e pranuar për një fermerë është nga 300m² – 500m² një serrë e pandarë, mund të aplikojnë edhe fermerët që kanë serra me sipërfaqe më të madhe, por maksimumi që iu pranohen fidanet është për 500m².

Përfitues do të jenë fermerët që i plotësojnë këto kritere:

- Të jetë banor i komunës së Ferizajt;
- Serrën ta ketë në komunën e Ferizajt;
- Fermerët që kanë serra me sipërfaqe 300m² e më shumë;
- Fermerët që nuk janë kultivues komercial të fidaneve të perimeve.

Fermerët e interesuar do të aplikojnë në Zyrën Pritëse(kati përdhese)- KK Ferizaj.
Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Fletëaplikacioni i plotësuar (mirret në Zyrën Pritëse);
- Fotokopjen e letërnjoftimit ;
- Çertifikatën për pronësi të tokës - fletën poseduese(original) ;

Afati për aplikim fillon nga data 22.02.2021 deri më 05.03.2021